

DRAFTI I
RAPORTIT TE VLERESIMIT TE
NDIKIMIT NE MJEDIS
TE AKTIVITETIT

"Prodhim vere dhe rakie"



Person Fizik : Esat Reçi
Hartoi: "EKO-STUDIO-PROJEKT"sh.p.k
Administrator : Shkelzen MADANI

Tirane 2018

PERMBAJTJA

+ Hyrje

+ Baza ligjore

+ Metodika e vleresimit te mjedisit

+ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

4. **MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**

5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobeseve ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proçes. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Prodhim vere dhe rakie”

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedis te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 10 266 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollleshme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*

- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*

➤ **Pershkrimi i metodikes se zbatuar per hartimin e raportit te VNM-se**


Hartimi i raportit te VNM-se behet me qellim qe te merren parasysh dhe te analizohen te gjitha faktoret kryesore dhe dytesore qe ndikojne ne mjedis gjate zhvillimit te aktivitetit. Ky raport gjithashtu ka si qellim te jape nje pasqyre te pergjithshme mbi efektet negative e pozitive ne mjedis, alternativat e mundshme dhe masat zbutese te efekteve te padeshirueshme.

Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte nje studim qe synon parashikimin e te gjitha efekteve te pritshme ne mjedis, qe do te rezultojne nga projekti i propozuar, si gjate zbatimit te tij dhe gjate funksionimit.

➤ **Profili i propozuesit**

Personi fizik Esat Reçi eshte regjistruar prane QKB ne daten 10/03/2003 me Numer unik te identifikimit të subjektit NIPT K37508315J .Ky subjekt do te zhvilloje aktivitetin e prodhimit te veres dhe rakise ,si lende e para per prodhimin e veres dhe rakise perdoret rrushi i cili do te merret nga vreshtat e vet subjektit si dhe nga blerja ne tregetare te ndryshem.Objekti te cilin zhvillohet aktiviteti ndodhet ne Lezhe Mamurras GJORM Fshati Gjorm,Rruga Kryesore,Banese Private 1 kateshe, Zona Kadastrale nr.1768, me pasuri nr.59/56.

Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore tipi B .



Pershkrimi i projektit

Linja teknologjike

Per te realizuar prodhimin e veres jane te domosdoshem paisjet e nevojshme.

Shtrydhsja e rrushtit



Ne kete kantine eshte zgjedhur shtrydhese e tipit Grifo e cila perdoret per bodrume me siperfaqe te vogel dhe te mesme .

Operacionet e kryera nga makina janë:

- shtypet me rrotullat e vendosura brenda vaskes
- heqja, dmth ndarja e kokrrave nga mbeturinat e përbërë nga kërcell, përmes boshtit të vendosur brenda trupit të makinës

Të dhëna teknike

Dimensionet maksimale të hapësirës: 60x60x120 cm

Pesha: 54 kg

Furnizimi me energji: 230 V 50 Hz

Dimensionet e Hopper: 90x50 cm

Diametri i rrotulluesve: 22cm

Shpejtësia e motorit: 1400 rpm

Shpejtësia përfundon: 90 rpm

Shpejtësia e rrotullës: 110 rpm

Shpejtësia e gishtit: 550 rpm

Prodhimi orar: 1500 kg

Temperatura e punës: nga 5 ° C deri 45 ° C

Niveli i zhurmës: më pak se 70dBA

Të dhëna elektrike

Furnizimi me energji: 230 V 50 Hz njëfazor

Konsumi aktual: 5.5 A

Fuqia 0.75 kW

Shkalla e mbrojtjes: IP 54

Filtri I tipit “ SPAGNI”

E ndërtuar në çelik inox Aisi 304 (ose në çelik të pikturuar në versionet F8 dhe F14), praktik dhe i

sigurt, ai gjithashtu i garanton prodhuesit të vogël cilësinë dhe sigurinë e filtrimit të lartë të produktit. Me pllaka polietileni 20x20 (sipas kërkesës në NORYL sterilizueshme në 120 ° C), matës presioni dhe valvula rregulluese të rrjedhjes.



Te dhenat teknike jepen ne tabelen e meposhteme eshte zgjedhur filter me 10pllaka

	F8	F10	F14	F20	F30	F40
N. cartoni	8	10	14	20	30	40
Dim. cartoni	200x200 mm	200x200 mm	200x200 mm	200x200 mm	200x200 mm	200x200 mm
Superfice filtrante	3,2 m ²	4,8 m ²	6,4 m ²	8,0 m ²	9,6 m ²	12,8 m ²
Produzione oraria	200 : 500 Lt/H	300 : 700 Lt/H	500 : 900 Lt/H	700 : 1400 Lt/H	1400 : 2000 Lt/H	1900 : 2800 Lt/H
Dimensioni	390X310X340 mm	390X310X340 mm	470X310X340 mm	500X700X650 mm	500X850X650 mm	500X1000X650 mm
Peso	Kg 19	Kg 20	Kg 21	Kg 36	Kg 47	Kg 58

Depozita prej inoksi 300L-2-cop



Rezervuar me çelik inox me lundrues konik 300 Lt. AISI 304 18/10

E bërë nga çelik inox AISI 304

10 ° fundi konik me përforcim

Kullimi total me 1 "ENO 30 valvula (3)

Shkarkimi i pjesshëm me 1 "valvul ENO 30 (1)

3 këmbë çelik inox

Bombla e ajrit prej çeliku të pandryshuar me tub plastik të pastër ushqimor (4)

Valvula me fryrje plastike me veprim të dyfishtë,

Siperfaqja e brendeshme: pasqyrë e lëmuar për pastrim dhe sanitizim të lehtë

Siperfaqja e jashtme jashtme: lule, me saldime të satinuara.

Përmasat:

diametri 640 mm. (D1)

lartësia 1000 mm (H3)

lartësia e këmbëve 400 mm. (H2)

lartësia totale 1400 mm (H1)

Trashësia:

Muret: 1 mm

Fundi: 1.2 mm

Përshkrimi teknik

ENO 30 çelik inox për PG 20

ENO 30 çelik inox për PG 25

Depozite inoksi 500L -2-cop



E bërë nga çelik inox AISI 304

10 ° fundi konik me përforcime

Kullimi total me 1 "ENO 30 valvula (3)

Shkarkimi i pjesshëm me 1 "valvul ENO 30 (1)

3 këmbë çelik inox

Bombla e ajrit prej çeliku të pandryshuar me tub plastik të pastër ushqimor (4)

Valvula me fryrje plastike me veprim të dyfishtë

Siperfaqija e brendeshme: pasqyrë e lëmuar për pastrim dhe sanitizim të lehtë

Siperfaqija e jashtme jashtme: lule, me saldime të satinuara.a.

Përmasat:

Diametri: 720 mm. (D1)

Lartësia: 1250 mm. (H3)

Lartësia e këmbëve: 400 mm. (H2)

Lartësia e përgjithshme me këmbë dhe brinjë: 1650 mm. (H1)

Trashësia:

Muret: 1 mm

Fondi: 1.2 mm

Përshkrimi teknik

ENO 30 çelik inox për PG 20

ENO çelik inox për PG 25

Bute druri 220L- 15-cop

Me permasa 95x70x60cm

But druri 140L -12-cop,me permasa

85x62x52cm

But plastic 500L -12-cop dhe bute plastike 200L-20-cop

Per te realizuar sa me mire funksionimin e linjes jane perdorur dhe aksesore te tjere

si,saracineska,kundra valvula,manometer etj

Kapaciteti perpunues njekohesisht I kesaj linje eshte 11.6m³ lende e pare (bersia e rrushit)

Kapaciteti magazinues vetem per butet e drurit eshte 4.98m³ leng . Per ruajtjen e veres ne shishe

kapaciteti varion nga 0.75m³ deri ne 1m³.

Ne kantine sistemi elektrik eshte bere sipas te gjithë rregullave teknike dhe normave te percaktuara me ligj.

Persa i perket prodhimit te rakise

Do te behet zierja e bersive qe dalin nga shtrydhja ne procesin e prodhimit te veres , zierja do te behet ne kazanin enkas per kete proces dhe ne nje ambjent te vaecuar nga ambjenti ku do te behet prodhimi i veres,me pas do te behet procesi i distilimit,ne prodhimit e rakise nuk perdoren lende ndihmese.

1. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Pershkrimi i qarkut te Lezhes

Trashegimia kulturore

Nga konstatimi ne zone, territori ne studim nuk ndodhet ne distanca te aferta me zonat e mbrojtura nga Instituti i Monumenteve te Kultures . Ne zonen ku ndodhet veprimtaria nuk ka objekte arkitektonike, arkeologjike, kulturore dhe me interesa historike.

Relievi

Relievi i rajonit është i ndryshëm në pjesën perëndimore është fushor me kuotë të ulët mbi nivelin e detit dhe në pjesën lindore është kodrinor – malor në të gjithë zonën e fshatrave të malësisë në një kuotë deri në 700 metra mbi nivelin e detit.

3.3 Klima

Në territorin e rajonit mbizotëron klima mesdhetare, ka fusha pjellore, ka kodrina të ulëta, ka vargmale me lartësi mbi 700 m mbi nivelin e detit, ka pyje të dendur. Klima mesdhetare me verë të nxehtë e të thatë e dimër të butë e të freskët, është tipike për zonën fushore e kodrinore. Karakteristike për çdo stinë të vitit janë erërat e forta që fryjnë nga verilindja dhe lindja e drejtohen nga korridoret natyrore, shpatet e maleve. Nga pikëpamja e temperaturave vërehen amplituda të mëdha midis dimrit dhe verës. Temperatura mesatare vjetore është 15,6 gradë celcius, kurse amplituda mesatare është 18 gradë celcius. Reshjet në territorin e rajonit kanë një shpërndarje të pabarabartë. Sasia mesatare e reshjeve është 1350mm në vit. Në zonën malore, kryesisht aty ku bie dëborë në dimër, reshjet janë të pranishme edhe gjatë verës, kurse në zonën kodrinore dhe fushore vera është e thatë. Ditët me diell variojnë nga 220-240 dite, ku mesatarisht gjatë vitit ka deri 3000 orë diell.

Flora dhe Fauna

Bimësia është e shpërndarë sipas kushteve klimatike, duke formuar zona bimësie si zona e shkurreve mesdhetare (zhvillohen shkurret, kryesisht shqopa e mareja), e dushqeve (lisi, gështenja), e ahishteve (ahu) dhe e halorëve (pisha). Duke u nisur sipas

vetive të përdorimit në zonë rriten edhe bimët mjeksore e aromatike që përmbajnë lëndë aktive dhe esenca. Bimët mjekësore që rriten në këtë zonë janë: sherbela, trumza, kamomili, lulebliri, çaj mali, luleshtrydha, lulëkuqja, mullaga. Në zonën tonë rriten edhe bimët spontane foragjere me vlera ushqimore për bagëtinë. Në bimësinë e livadheve dhe kullotave mbizotërojmë graminoret dhe bishtajoret në gjendje të egër si: tërfili, grami, talla, shpatorja. Bimët endemike janë bimë që rriten vetvetiu brenda një territori të caktuar të kufizuar dhe rriten në vartësi të relievit e klimës. Fauna është zhvilluar në varësi të mjedisit. Kështu dallohen fauna tokësore, fauna e ujrave të ëmbla dhe fauna e egër. Shpendë të gjuetisë janë rosa e pata e egër, thëllënxa, karabullakët, çapkat etj. Kafshë të egra që rriten në këtë zonë janë dhelpra, lepuri, ujku, ariu dhe derri i egër.

Gjeologjia dhe dherat

Formësimi gjeologjik i përket periudhës së rrudhosjes alpine këtu e 225-milion vjet më parë. Në këtë strukturë gjeologjike ka shkëmbenj të shumtë sedimentarë, magmatike dhe metamorfikë me rezerva të pasura xeherorësh, bakri, kromi, silici, kuarci, kauline, gurë dekorativ e gëlqerorë, argjila, inerte etj. Me një traditë të hershme në përpunimin e tyre, të mjaftueshme për ngritjen e shumë aktiviteteve industrialo-ekonomike.

Mjedisi natyror, peisazhi e llojshmëria biologjike

Natyra e rajonit të Lezhës është një trashëgimi e pasur vlerash të relievit, llojshmërisë biologjike, klimës e mikroklimes.

Larmia e pafund e peizazhit është e kushtëzuar nga një reliev që të befason me ndryshimin e shpejtë dhe bukurinë në çdo stinë të vitit.

Një natyrë e rrallë nga bujaria, që ofron peizazhe mahnitëse që nga ultësisirat bregdetare me plazhe, delta e ligatina të Gjirit të Drinit, lugina me kanione joshëse mahnitëse të Matit me degët e Fanit, me pyje të larta halorësh e gjetherënëse, çeltira e livadhe të Bjeshkëve të Oroshit e të Nenshejt e deri lartësitë shkëmbore të Munelles.

Bregdeti i sheshtë adriatikas, me plazhe të mrekullueshme, me deltat e lumenjve Drin e Mat, pason në lindje me një ansambël habitatesh ligatinore. Në kallamishtet që shpojnë pasqyrat ujore lagunore, e në vegjetacionin e ngjeshur kënetor e pyjor në anë të tyre, të josh prania dhe fluturimet spektakulare të çafkave, pulëbardhave, rosave e karabullakëve etj.

Për peizazhin me male mbi laguna e plazhin me ujë të qetë dhe mbi të gjitha faunën e florën e mrekullueshme, kjo zonë është shpallur në vendin e parë në Konferencën Mesdhetare të Algjerit (1988). Ndërsa ndër vite, është vlerësuar si perlë e natyrës shqiptare e privilegj i saj.

Ekosistemet ligatinore bregdetare të Kunes, Vainit, Tales, Patokut, Fushe Kuqe e Ishmit, me një sipërfaqe prej 6230.31 ha, të lagura nga deti Adriatik në 26.7 km vije bregdetare, janë të shpallura me ligj, zona të mbrojtura natyrore.

Ky kompleks natyror është i njohur në botë si hapësirë e rëndësishme për shpendët (Important Bird Area – IBA), ku jetojnë rreth 203 lloje. Për shumëllojshmërinë e shpendëve, zona është quajtur “Oaz i ornitologjisë së Mesdheut” ku popullojnë më shumë çafkat, karabullakët, rosat, baltaket, pulëbardhat etj.

Shumë lloje faunistike botërisht të rrezikuara, kanë një pjesë të arealit në këtë ekosistem. Në zemër të Ishullit të Kunes, midis shkurreve e drurëve të shumëllojshëm, ndodhet Këneta e Kashtës, e cila është një monument i rralle natyror. Ajo ushqehet me ujërat e lagunës së Merxhanit, nëpërmjet të një kanali lidhës. Gjire të vogla me plazhe me rërë e ujë të pastër, shpat gëlqeror më pishë e larmi drurësh të tjerë e shkurre, e përbëjnë bregdetin në veri të Shëngjinit. Në buzë të malit, ndodhen vatra me bimën e rrallë aromatike të mërsinës.

Si më i veçantë i këtij bregdeti, është gjeomonumenti natyror, i rralle në llojin e vet, Rana e Hedhun. Objekti përfaqëson një mbushje të qëndrueshme me rëre të imët e të zakonshme plazhi, të një pjese shpati bregdetar që arrin në një lartësi deri 90 m e gjerësi 200 m.

Mali i Rrencit, me kreshtën më të dallueshme gëlqerore të njohur me emrin Maja e Zezë, karakterizohet nga peizazhi tokësor gëlqeror karstik. Kjo zone, peizazh natyror i mbrojtur, është e njohur dhe për zvarranikët e shpendët grabitqarë. Shpatet gëlqerore të malit të Molungut e ato të Velës që ngrihen mbi të, ekspozohen me madhështi përball peizazhit fushor e bregdetar. Labirintet luginore të lumenjve Fan e Mat, të afrojnë më në thellësi shpate e kreshta malore monumentale.

Mali i thepisur gëlqeror i Veles, ai i Munellës e i Vinjollit më në lindje, zbardhojnë nga dëborë në dimra të zgjatur e që mund të soditet si sfond i këndshëm nga mjaft qytete e fshatra.

Ato gjithashtu përfaqësohen nga formacione karstike të pasura me hinka, puse e shpella.

Bjeshkët e Oroshit shtrihen në veri te Komunës Orosh, përfaqësohen me formacione gjeologjike mjaft interesante e me vlera shkencore. Pyjet halore si dhe gjethegjera, shumëllojshmëria biologjike, burimet e shumta e variacionet e relievit, ofrojnë një galeri pamjesh monumentale të natyrës.

Në mrekullinë peizazhiste, janë ngulmuar harmonishëm një numër i konsiderueshëm fshatrash.

Mjaft prej banorëve të tyre kanë ruajtur vlerat e traditës ndërtimore të banesave të gurta një e dy katëshe të kompozuara hijshëm në shpate e sheshe. Krahas privilegjeve që ofron natyra për banorët, me shpatet me pyje, gështenjë, arrë e lajthi, ato kultivojnë një larmi drurë frutoresh, drithëra e perime ku dallohen kultivarët autokton si misri “gushtak”, rrushi “tajkë” e “kallmet”, etj.

Në verilindje të fshatit Kallmet, gjendet një ansambël pyjor mjaft interesant e i shumëllojshëm, monument natyror, në brendësi të të cilit ndodhet kisha e njohur e Shën Eufemisë.

Në mozaikun natyror të rajonit, janë të pafund objektet më tipare të veçanta si monumente të natyrës, disa nga të cilët mbrohen më ligj.

Pjesë e shumëllojshmërisë bimore, janë dhe bimët mjekësore, tanifere e eterovajore si trumza, lisra, murrizi, trëndafili i egër etj. Sherbela është më e veçanta.

Në këtë parajsë natyrore gjallojnë si më të pranishëm gjitarë të mëdhenj si dhelpra, lepuri, ujku, kunadhja, por në areale më të larta si Vinjulli vrojtohen dhe kaprolli e ariu.

Në komunitetin faunistik shumëllojshmëria e shpendëve spikat në mënyrë të veçantë. E gjitha zona malore e rajonit të Lezhës përfaqësohet nga formacione të karstit, të pasur me puse, shpella e hinka karstike dhe disa prej tyre janë shpallur monumente natyrore të cilët mbrohen më ligj.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe kerkesave te VKM Nr. 686, date 29.07.2015 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” dhe ka si synim identifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e demtimi. Kjo perben perparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- **Territori perreth objektit**

I gjithe territori i objektit dhe rruga hyrese ne te eshte e shtruar dhe e sistemuar. Jane marre masa edhe per gjelberimin e territorit perreth aktivitetit duke bere te mundur mbjelljen me peme dhe lule kjo dhe per faktin qe aktiviteti eshte ne katin e pare te viles se banimit te administratorit.

- **Emetimet ne ajer**

Referuar natyres se procesit nuk ka sasi gazesh te shkarkuar ne atmosfere sepse makinerite punojne me energji elektrike e cila eshte nje burim i paster energjie ose jane manuale .

Mbetjet e ngurta

Si rezultat i zhvillimit te ketij aktiviteti nuk do te kemi shkarkime ne toke. Mbetjet e ngurta si: frenjte,bersite dhe materialet e tjera organike që do të gjenerohen do te menaxhohen si me poshte:

-frenjte e rrushit jane ne sasi rreth 3.5 % e lendes se pare do te grumbullohen ne ambientet e kantines dhe me pas administratori do ti perdori per pleh per tokat me te mbjella qe ka ne zoterim.

-Bersite qe permbajne pjese te cipes,tullit apo edhe nje pjese te farave te rrushit do te perdoren per prodhimin e rakise.

Te gjitha mbetjet e siperpermendura si frenjte dhe bersite qe permbajne pjese te cipes,tullit apo edhe nje pjese te farave te rrushit ,administratori do ti perdori per pleh per tokat me te mbjella qe ka ne zoterim.

Ndersa mbetjet urbane te gjeneruara nga stafi qe do te punoj do te grumbullohen ne ambientet e caktuara brenda kantines per tu derguar me pas ne vendet e caktuara nga pushteti vendor.

- **Shkarkimet e ujerave**

Uji perdoret ne nje sasi te vogel per procesin, per larjen e makinerise shtypse,kazaneve te inoksit dhe bidonave plastik ku do te qendroj vera gjate procesit te fermentimit, per sherbime higjieno-sanitare per stafin e punes ne kantine. Keto ujera nuk permbajne ndotje, dhe shkarkohen ne ne rrjetin e kanalizimeve te zones.

- **Zhurmat**

Zhurmat shkarkohen nga makinerite brenda ambienteve te punes,por keto zhurma jane brenda normave te lejuara per nje aktivitet te tille.Keto zhurma jane vetem ne momentin e shtypjes se rrushit si dhe te vendosjes se tapave Ne perimetrin e jashtem zhurmat jane ne parametrat dhe ne normat e lejuara dhe nuk perbejne problem shqetesues as per banimin qe eshte ne katin me larte ,aq me pak per banoret ne afersi te aktivitetit te cilet jane ne nje distance te konsiderueshme.

- **Kushtet e punes**

Persa i perket sigurimit teknik te punonjesve,ky aktivitet nuk perdor lende te rrezikshme apo mjete te tilla te cilat te vene ne rrezik jeten e punojsve ,e vetmja pajisje ekelktrike eshte shtypsja e rrushit per te cilen punojsi i cili do ta vendos ne perdorim eshte trainuar ,lidhja elektrike eshte bere nga punojsit e OSHE.

- **Mbrojtja nga zjarri**

Nga ana e administratorit janë marrë masat për mbrojtjen në rast rënies të zjarrit si dhe zbatimi i rregullave të sigurimit teknik. Në ambientet e kantinës janë vendosur në vende të dukshme fikset konform rregullave të sigurisë.

4. MASAT PËR ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

Masat e marra për shkarkimet e ujërave të përdorura

Uji në procesin teknologjik do të përdoret vetëm për larjen e linjes së prodhimit e cila do të pastrohet në fund të procesit, të prodhimit, do të lahen kryesisht, shtrydhesja, depozitat e inoksit, depozitat plastike si dhe butet e drurit si dhe do të pastrohet filtri. Uji i gjeneruar nga larja e linjes së prodhimit si dhe ujrati që do të gjenerohen nga përdorimi i tualetëve nga stafit që do të punojnë në kantine do të derdhen në rrjetin e kanalizimeve të zonës. Ujrati i gjeneruar nga larja e linjes së prodhimit nuk do të kenë përmbajtje kimikatesh, pasi linja e prodhimit do të pastrohet thjesht me ujë të bollshëm gjithashtu nuk do të ketë përmbajtje të copave të rrushit, apo bërësive të cilat do të largohen që në fazën e pare.

Masat e marra për menaxhimin e mbetjeve të ngurta

Si rezultat i zhvillimit të këtij aktiviteti nuk do të kemi shkarkime në tokë. Mbetjet e ngurta si: frenjtë, bërësive dhe materialet e tjera organike që do të gjenerohen do të menaxhohen si më poshtë:

-frenjtë e rrushit janë në sasi rreth 3.5 % e lëndës së pare do të grumbullohen në ambientet e kantinës dhe me pas administratori do të përdori për pleh për tokat me të mbjella që ka në zotërim.

-Bërësive që përmbajnë pjesë të cipes, tullit apo edhe një pjesë të farave të rrushit do të tretohen tek prodhuesit e rakisë.

Të gjitha mbetjet e sipërpermendura si frenjtë dhe bërësive që përmbajnë pjesë të cipes, tullit apo edhe një pjesë të farave të rrushit janë rreth 36 % e lëndës së pare.

Ndërsa mbetjet urbane të gjeneruara nga stafit që do të punojnë do të grumbullohen në ambientet e caktuara brenda kantinës për tu dërguar me pas në vendet e caktuara nga pushteti vendor.

Rastet aksidentale

Do të merren masat për parandalimin e rasteve aksidentale, pajisjet do të kontrollohen vazhdimisht për gjendjen teknike të tyre.

Sigurimi teknik në punë

Përsa i përket sigurimit teknik të punonjësve ata do të jenë të mirë informuar mbi rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punës, konform rregulloreve përkatëse për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit. Gjithashtu punonjësit do të pajisen me uniforma.

Mbrojtja e shëndetit dhe siguria në punë janë në qendër të vëmendjes së subjektit. Për të mbajtur një regjim të fortë të sigurisë në punë dhe shëndetit të plotë të punonjësve do të merren masat e mëposhtme:

Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike do te instruktohen per rreziket ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.

Do te punesohen punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialiste te profesioneve qe kerkojen.

Do te punesohen punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion. Masat per mbrojtjen nga zjarri do te jene pjese e instruktiveve e te tabelave lajmeruese e parandaluese.

Mbrojtja nga zjarri

Ne zbatimin e gernes b, te nenit 34, te Ligjit Nr.8766 date 05.04.2001 “Per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin”, jane marre masat e nevojshme per mbrojtjen ne raste rreziku apo renie zjarri. Per nje siguri maksimale ne ambientet e punes nga drejtuesit e saj, jane marre te gjitha masat per zbatimin e rregullave te sigurimit teknik dhe te mbrojtjes nga zjarri.

Brenda objektit jane vendosur ne vende te dukshme paisje te mbrojtjes nga zjarri, si dhe jane marre masa per te kryer instruktimin e punonjesve ne menyre periodike.

Per mbrojtjen nga Zjarri jane marre masat e meposhtme:

Renia e zjarrit

Rezikshmeria e zjarrit ne kete objekt mund te vij nga prania e buteve te drurit pasi ne kantine do te kete bute druri, per kete arsye subjekti disponon fikse me shkume te cilat jane te pershtatshme per shuarjen e zjarreve te tipit A ku perfshihet dhe druri.

Zjarret e tipit **A** mund te fiken me uje, shkume apo pluhur kimik. Rreziku nga zjarret e tipi **A** jane tymi, gazrat toksik dhe shperndarja e copezave gjate fikjes. Fikeset e tipit **A** zakonisht kane uje ose shkume. Mos i perdor ato ne zjarret elektrik- **Rrezik korenti!**

Rastet e zjarrit ne kete objekt mund te vijne edhe nga energjia elektrike per kete arsye subjekti disponon fikse me pluhur kimik CO2 te cilat jane te pershtatshme per shuarjen e zjarreve te tipit C ku perfshihet dhe energjia elektrike pasi me fikse te tjera mund te te zej korrenti.

Keto fikse gjenden ne ambientet e kantines ku jane vendosur edhe tablelet per mbrojtjen nga zjarri.

Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese

Realizimi i objektiveve dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjitha treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes do te çojne perfundimisht ne perfhtimin e pamjeve te parashikuara ne projekt, me sipërfaqe te pastra, te sistemuara e te gjelberuara.

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione

- Ky aktivitet ne procesin e prodhimit nuk perdor lende te demshme te ngurta apo te lengeta qe shkarkohen ne ambient dhe qe mund te demtojne mjedisin.
- Teknologjia e perdorur gjate proceseve te punes eshte e perparuar dhe sipas standarteve te Bashkimit Evropian.
- Ky aktivitet nuk ka ndikim negativ ne popullsi, nuk prek zona te mbrojtura, objekte te rendesise se vecante.
- Gjate aktivitetit nuk ka ndotje te tokes, ujerave dhe ajrit.
- Per nje siguri maksimale në impiant zbatohen, ne menyre te perpikte, rregullat e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes kunder zjarrit.
- Aktiviteti nuk ka efekte anesore ne mjedis dhe me masat e marra nuk ka premisa qe te sjelle ndotje mjedisit apo pasoja negative per shendetin e njerezve te flores dhe faunes.

Punoi: ” Eko Studio projekt ” shpk